



Republika e Kosovës

- Këshilli Komunal Për Siguri në Bashkësi (KKSB)–

01.Nr. zyrtar/ 2024



Komuna e Kaçanikut

Procesverbal

Takimi i III-të i Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi për vitin 2024

Më 18.06.2024

Në takim prezantuan:

Besim Ilazi, Kryetar i Komunës

Zahir Doda, DKA

Halim Shehu, Stacioni i Policisë-Kaçanik

Fidaim Fazliu-KBI

Fatmir Qaka, EVSB

Bujar Bajra-Sektor i Emergjencave Civile Komunale

Fadil Guri-ZKK

Elmihane Malsiu-HANDIKOS

Naim Hysa-Kryqi i Kuq Komunal

Jashar Selimi-Këshilli i Prindërve

Menduh Krasniqi-Inspektorati Komunal

Ylber Tusha-Përfajqsues i bizneseve

Shemsedin Abazi-KLSP

Mbledhjen e kryesoi Kryetari i Komunës me këto pika të rendit të ditës :

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar
2. Gjendja e sigurisë në territorin e Komunës së Kaçanikut
3. Raporti i Drejtorisë së Arsimit rreth aktiviteteve të organizuara për maturantët
4. Aktivitetet e planifikuara të komunës gjat sezonit të verës (aktivitetet kulturore e sportive, vetdijsimi i qytetarëve për mbrojtje nga zjarri, planet operative për sezonin e pushimeve të mërgimtarëve, parandalimi i zhurmës akustike, dasmat etj)
5. Të ndryshme

1. Procesverbali u miratua nga të pranishmit

2. Gjendja e sigurisë në territorin e Komunës së Kaçanikut

Në pikën e dytë të rendit të ditës për periudhën në mes dy takimev Kryetari fjalën ia dha Komandantit të Stacionit të Policisë në Kacanik z. Halim Shehut

Halim Shehu – Gjendja e sigurisë në Komunën tonë në periudhën në mes dy takimeve ka qenë e qetë dhe stabile me përjashtim të disa rasteve që do i raportoj.

Gjithsejtë janë 52 raste ku prej tyre 8 raste janë vjedhje, vjedhje e rëndë 6 raste ku janë të arrestuar dy persona, vjedhje e rëndë në tentativë kemi një rast, dëmtim prone një rast, kanosje 5 raste, sulm një rast, dhunë në familje 5 raste ku si dukuri është shqetësuese, dëmtim të instalimeve publike 3 raste, armëmbajtje pa leje 2 raste, pengim i personit zyrtarë në kryrjen e detyrës një rast, një rast dhunim, ngacmim një rast, hyrje në systemin kompjuterik një rast, pasiguri në punë një rast, shpërdorim i pasurisë një rast, dhe mashtrim një rast.

Kemi bërë planin operativ për sezonin verorë dhe jemi në implementim përkundër që kemi numër të vogël të zyrtarëve Policorë .

Për shkak të punimeve që janë duke u bërë në linjën hekurudhore te guri i shpum është shtuar fluksi i automjeteve në qendër të qytetit dhe ky fluks do të shtohet në ditët në vijim .

Shqetësim është gjithashtu edhe degradimi i pyjeve që sipas mendimit tim më mirë është të thuhet shkretim i pyjeve që gjobat për dëmtuesit duhet të jenë të mëdha por që këto gjoba janë simbolike dhe këta dëmtues vazhdojn me këtë veprimtari .

Fidaim Fazliu – Jemi në një kohë kur keqëbërsit ledhatohen ndërsa ndaj personave që kryejn punë zyrtare mirren masa ndëshkuese .

Po ndërlihem me një kërkesë të OVL – Dega në Kaçanik për vendosjen e flamurit të UÇK – së në Minaret e Xhamisë të cilën kërkesë ne si institucion e kemi aprovuar .

Një person i pa autorizuar ka marrë qelësat e Xhamisë dhe e ka larguar flamurin .

Ky rast është lajmëruar në Polici dhe ndaj këtij personi nuk është marrë asnjë masë .

Raste të tilla ka pasur edhe në të kaluarën ku persona të pa autorizuar 15 ditë kanë kidnapuar Xhaminë dhe habitem që nuk mirren masa ndaj këtyre personave .

Me keqardhje mundë të them se raste të tilla më nuk do ti lajmroj ngase po i humb edhe kredibiliteti këtij institucioni .

Çka është më shqetësuese kur nga Prokurori thuhet që të denoncohet rasti për vjedhje të qelsit por jo për largimin e Flamurit .

Halim Shehu – Lidhur me këtë rast janë arrestuar dhe është hapur procedurë hetimore dhe hetimet lidhur me rastin e bën Prokurori i cili thotë që për të ngritur një rast duhet të ketë qëllimin, dëmin dhe shkaktarin dhe sipas Prokurorit personi i dyshuar nuk i ka këto elemente .

Deklarata e personave të arrestuar është që Kryetari i Bashkësisë Islame pëlqimin e ka dhanë pa u dakorduar me xhematëlinjë të ndërsa qelësin e ka marrë nga vet Imami .

Fadil Guri – Personat në fjalë janë individë dhe në bazë të asaj çka po dëgjojë i kanë pasur tri elemente: edhe qëllim edhe dëm edhe shkak .

Në këtë rast institucionet e sigurisë duhet të bazohen në deklaratat e personave zyrtarë të Bashkësisë Islame e jo në individ ngase ky institucion i ka edhe organet e saja që e drejtojnë Xhaminë .

Halim Shehu – Rasti i njejtë ka ndodhë edhe në Xhaminë e fshatit Bob por që nuk kanë hapur ndonjë rast .

Fidaim Fazliu – Vendosjen e simboleve Kombëtare nëpër institucione fetare e kemi edhe me kushtetutë dhe ne si institucion vendosim që të japim pëlqim për vendosjen e tyre por jo të vendosin të tjerët që nuk kanë kurrfar pozite dhe njohuri për këtë çështje .

Po më habit fakti që Komandanti po thotë se personat janë arrestuar kur të njejtit prapë e kanë përsëritë të njejtin veprim pasi që Flamuri është rivendosë .

Qelësat i janë marrë me dhunë personit të autorizuar dhe kjo më shqetëson më së shumti që këta persona po faktorizohen .

Kryetari – Organet e Drejtësisë kanë kryer detyrën e tyre dhe ne nuk mundë të ndërhyjmë në punët e tyre ndërsa rasti ka mundë të hapet si marrje me dhunë e qelësave .

3.Raporti i Drejtorisë së Arsimit rreth aktiviteteve të organizuara për maturantët

Izahir Doda – Sa i përket organizimit të aktiviteteve me Maturantët DKA në bashkëpunim me dy Shkollat e Mesme me kohë i kemi bërë përgatitjet dhe mundë të themë se mbrëmja e Maturës ka kaluar pa më të voglin ekces .

Jemi në përgatitje të testit të maturës që do të mbahet këtë muaj dhe i kemi marrë të gjitha masat që punët të ecin mbarë .

Përmes zyrës së orientimit në karrierë jemi munduar që të i orientojmë edhe Maturantët për përzgjedhjen e drejtimeve që ata mendojnë të studijojnë .

U kemi ofruar bashkpunim si Fakulteteve Publike dhe atyre private për zhvillim të aktiviteteve dhe projekteve të ndryshme .

Në përgjithësi mundë të them se të gjitha aktivitetet që janë organizuar kushtuar Maturantëve kanë shkuar mir dhe pa ndonjë problem .

Fidaim Fazliu – Më vjen mirë që po dëgjoj këto fjalë nga Drejtori i Arsimit por që po më duket diçka e tepërt publiciteti që po i ipet mbrëmjes së Maturës dhe mendoj që ky organizim të reduktohet mbrenda objektit shkollor dhe të gjindet ndonjë formë e organizimit modest ngase nuk besoj që në vendet tjera të botës i japin publicitet siq bëhet tek ne .

Fadil Guri – Mbrëmja e maturës është një fest për maturantët që do e mbajn mend tër jetën dhe duhet pyetur edhe vullnetin e tyre si të organizohet .

Elmihane Malsiu – Edhe unë jam që festa e Maturës duhet të vazhdoj si traditë dhe për mënyrën e organizimit duhet të vendosin vetë Maturantët me organet e Shkollës por që mësimdhënsit duhet të jenë sy qelë për të evituar ndonjë ekces të mundshëm .

Izahir Doda – Festa e Maturës organizohet në tër botën por që forma e festimit dallon .

4. Aktivitetet e planifikuara të komunës gjat sezonit të verës (aktivitetet kulturore e sportive, vetdijsimi i qytetarëve për mbrojtje nga zjarri, planet operative për sezonin e pushimeve të mërgimtarëve, parandalimi i zhurmës akustike, dasmat etj)

Bujar Bajra – Drejtori për Emergjencë ka një plan operativ që ka filluar së implementuari dhe me kohë i kemi marrë të gjitha masat për implementimin e këtij plani .

Aktivitetet që i kemi paraparë për këtë sezonë janë edhe njoftimet dhe publikimet që janë bërë për vetdijsimin e qytetarëve për zjarret që mundë të shfaqen në këtë sezonë .

Menduh Krasniqi – Edhe inspektorati Komunal e ka planin operativ i dalur nga plani i punës së ekzekutivit Komunal dhe së bashku me Policinë do të mundohemi që të jemi në nivel të detyrës për të parandaluar disa dukuri që mundë të shfaqen në këtë sezonë .

Inspektorët Komunal do të angazhohen edhe pas orarit të punës dhe po shpresojmë që do ta kalojmë mirë edhe këtë sezonë .

Kryetari – Përveç aktiviteteve vetdijsuese ,përmes DKRS – së ne si Komunë kemi paraparë edhe aktivitetet kulturore edhe sportive .

Fatmir Çaka – DKRS veq sa ka filluar me aktivitetet e planifikuara për këtë sezonë .

Aktivitetet e shumta i kemi pasur sidomos në këtë muaj duke shënuar 1 Qershorin Dita Ndërkombëtare e Fëmijëve , 11 Qershorin – Ditën e Qlirimit që është shoqëruar me Festivalin tradicional të këngëve dhe valleve popullore dhe do të vazhdojmë me aktivitete për javën e Diasporës dhe 10 Gushtin – Dita e Dëshmorëve .

Krahas këtyre aktiviteteve ky muaj ka rastisë që të filloj Kampionati Evropian i Futbollit dhe në si Komunë me kërkesë të disa të rinjëve e kemi mundësuar shfaqjen e ndeshjeve në ekran të hapur te Sheshi i Qytetit falë edhe disa donatorëve .

Kampionati veq sa ka filluar dhe për të kaluar mirë nevojitet një bashkpunim dhe ndihmesë e Institucioneve tjera siq janë Kompania e Pastërtisë , Zjarrfikësit dhe Policia e Kosovës .

Është e treta ditë dhe atmosfera festive sportive ka kaluar pa ndonjë problem .

Halim Shehu – Lidhur me kët aktivitet unë kam pranuar një thirrje telefonike jo zyrtare nga një individ i cili ka kërkuar që një patrullë e Policisë të jetë prezent te sheshi por që njoftimet dhe kërkesat duhet të bëhen në mënyrë zyrtare dhe konkrete .

Rekomandimet

1. Të mirren masa ndaj personave që pengojnë zyrtarët publik në kryerjen e detyrës .
2. Inspektorët Komunal dhe Policia të jenë më aktiv sidomos në kët sezonë kur ka fluks të madh të automjeteve dhe njerëzve .
3. Për çfardo tubimi të hapur njoftimet të bëhen me kohë dhe të jenë konkrete .

Kryesoi: Kryetari – z. Besim Ilazi



Procesëmbajtës: Fatmir Qaka